

VENDIM
Nr. 911, datë 22.12.2014

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN “RSM”, NË SHTABE TË NDRYSHME TË NATO-S, NË AFGANISTAN¹

(Ndryshuar me VKM nr.343, datë 12.6.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përbërë nga 15 *(pesëmbëdhjetë)* ushtarakë, në shtabe të ndryshme të NATO-s, në Kabul dhe Herat, Afganistan, si më poshtë vijon:

Në Shtabin e Resolute Support Mission (RSM HQ), në operacionin “RSM”, në Kabul, Afganistan:

- Numri i pjesëmarrjes, 3 (tre) ushtarakë;
- Venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Trajnim - Këshillimit dhe Ndihmës (TAAC - Capital), në operacionin “RSM”, Kabul, Afganistan:

- Numri i pjesëmarrjes, 4 (katër) ushtarakë;
- Venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Operacioneve të Forcave Speciale të NATO-s (NSOCC-A), në operacionin “RSM”, në Kabul, Afganistan:

- Numri i pjesëmarrjes, 2 (dy) ushtarakë;
- Venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Trajnim - Këshillimit dhe Ndihmës (TAAC-West), në operacionin “RSM”, në Herat, Afganistan:

- Numri i pjesëmarrjes, 6 (gjashtë) ushtarakë;
- Venddislokimi, Herat, Afganistan.

2. Misioni i personelit, që do të marrë pjesë në shtabet e sipërpërmendura, është mbështetja dhe dhënia e kontributit në funksione të ndryshme në shtabet e trajnimit, këshillimit dhe dhënies së ndihmës, në operacionin e NATO-s “RSM”, Afganistan.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të përfaqësuesit të parë në Afganistan. Periudha e qëndrimit në mision për çdo përfaqësues do të jetë me sistem rotacioni në çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të

¹ VKM nr. 911, datë 22.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.204, datë 7 janar 2015.
VKM nr.343, datë 12.6.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.89, datë 19 qershor 2018.

transportit strategjik). Për postet Crisis Establishment (CE) që plotësohen nga oficerë me gradën “Kolonel”, rotacioni të jetë 1 (një) vit.

4. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

ë) aktivitete social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

5. Transporti i personelit që do të shërbejë në Afganistan, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t’u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, luanteria të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy - ose shumëpalëshe ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

6. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama